



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA
KOSOVA**

KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

VU644-24-12356-5-2-5/C1021

14 Nr. 132/2025

Dt. 12.03.2025

ANEKS KONTRATË PUNE

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi e ZPP-së** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. HYSNIA me arbk 8106829723 ; POUK Group SH.P.K me arbk 811492909., me seli **VUSHTRRI, 42000, VËRNICË, Kosovë**, të cilën e përfaqëson **z. Hysni Shabani**, në tekstin e mëtejme: **KRYESI I PUNËVE**, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve shtesë, si në vijim: **Ndërtimi i rrugës Avni Saraqi dhe Viciana Vushtrri** me numër identifikues:

Nr¹ i prokurimit	VU644	24	12356	525
Nr² i Brendshem	VU644	24	094	525

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Ka te bej me Ndërtimi i rrugës Avni Saraqi dhe Viciana Vushtrri**, andaj eshte nevoj emerxhente intervenimi - kryerja e instalimeve pasi që infrastruktura është në ekzekutim dhe leshimi ne qarkullim i rrugës është nevoj urgjente.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit. Afati i fillimit të punëve është **1 (një) ditë pas lidhjes së Aneks Kontratës**, ndërsa ekzekutimi i punëve dhe / ose shërbimeve duhen të përfundohen në afatin, jo më gjatë se **7 ditë pas datës së fillimit të ekzekutimit të Punëve dhe / ose Shërbimeve**.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, ne perputhje me nenin 16.3 te RUOPP " Ne rast te Aneks kontratave, AK duhet te përdore numrin baze te aktivitetit te prokurimit duke i shtuar ne fund numrin /5. Ne rast se ka me shume se një Aneks kontrate për te njëjtin aktivitet te prokurimit AK duhet te shtoj numrin /5-1, /5-2 etj"

² Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, ne perputhje me nenin 16.3 te RUOPP " Ne rast te Aneks kontratave, AK duhet te përdore numrin baze te aktivitetit te prokurimit duke i shtuar ne fund numrin /5. Ne rast se ka me shume se një Aneks kontrate për te njëjtin aktivitet te prokurimit AK duhet te shtoj numrin /5-1, /5-2 etj"

1.3 Vendi i ekzekutimit të punimeve është: rruga e Avni Saraqi dhe Vicianë Vushtrri sipas Kontratës bazë nr. 890/23 dt. 25.03.2023

1.4 Incotermini i aplikueshëm do të jetë DDP³ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **10,578.62 EUR** euro.

3.2 Mjetet për realizimin e projektit janë siguruar nga fondet e Komunës së Vushtrrisë.

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit teknik të Punëve dhe / ose shërbimeve të ekzekutuara të konfirmuara nga Komisioni i Pranimit Teknik i emëruar nga ZKA i A.K.. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Komisioni i Pranimit Teknik do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për punimet dhe / ose shërbimet e përfunduara dhe / ose pranuar.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti respektivisht cilësia e punëve dhe / ose shërbimeve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

³ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare



Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni, sipas kontratës bazë me nr.890/2023, pas pranimit të punëve dhe / ose shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,10% në ditë të vlerës së punëve dhe / ose shërbimeve të pa përfunduara/dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:


- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:
Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P.
HYSNIA ; POUK Group SH.P.K.,

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e
Vushtrrisë

Emri:	Hysni Shabani	Emri:	Ilmi Azemi
Pozita:	Pronar	Pozita:	ZPP-së
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	12.03.2025	Data:	12.03.2025
Vula:		Vula:	